



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit, Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Sh.A. si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfË Frankfurt AM Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 Kv Shqipëri – Kosovë (Tiranë-Prishtinë)””.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Eduard Selami, Gert Bogdani, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Valentina Leskaj, Ben Blushi, Kastriot Islami.

Mungojnë:

Jozefina Topalli, Olta Xhaçka, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Përparim Spahiu, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Z. Agim Bregasi, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Elektro-energjetik, MEI,
Znj. Aurora Alimadhi, Drejtoria Juridike, MEI

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Të nderuar kolegë, nisim mbledhjen e Komisionit. Sicc jeni në dijeni, Kuvendi në seancën e datës 6 Shkurt miratoi një vendim për të shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar Projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe projektit, Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Sh.A. si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt AM Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 Kv Shqipëri – Kosovë (Tiranë-Prishtinë)”. ”.

Për të folur për këtë akt kemi të ftuar specialistë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, zotin Agim Bregasi, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Elektro-energjetik dhe zonjën Aurora Alimadhi, Drejtoria Juridike.

Agim Bregasi – Siç është në relacion për projektligjin, bëhet për të shtyrë afatin e disbursimit. KfW kërkon shtyrje. Marrëveshja në thelb nuk ndryshon pork a skaduar afati. Projekti është i rëndësisë së veçantë, rrit sigurinë e furnizimit për Shqipërinë dhe Kosovën.

Në sistemin tonë energjetik janë lidhjet Elbasan – Mali i Zi dhe Elbasan – Greqi. Nëse nuk punon njëra nga linjat krijohen probleme.

Pjesë e strategjisë, është rritja e koeficientit që kemi. Kosova rreth 100% e prodhon me TEC, Shqipëria rreth 100% me HEC. Ky projekt ka një rëndësi të jashtëzakonshme për 2 vendet.

Gjatësia e linjës është 242 km, distanca Tiranë – Prizren. Nga Tirana në kufirin me Kosovën është 155 km. E vecantë për këtë linjë është që distanca nga Vau i Dejës – Mali i Zi shfrytëzon linjën ekzistuese, pra dyfishtë.

Avantazh në këtë rast është kursimi, nuk kërkohen shpronësime. Pjesa tjetër është Vau i Dejës – Kufi.

Duhet theksuar që është bërë gara, dhe është zgjedhur zbatuesi. Në këtë projekt janë 2 lote: Linja dhe pajisjet e përputhjes.

Arta Dade – Këto janë informacione që janë dhe në relacion. Cili është thelbi?

Agim Bregasi – Përgjithësisht, KfW ka rënë dakord për shtyrjen e afatit të disbursimit dhe do një konfirmim, do dhe konfirmimin e marrëveshjes zbatuese.

Arta Dade – Atëherë, zotërinj deputetë, a ka pyetje ose komente? Jemi dakord (deputetët shprehen dakord). Miratohet

MBYLLET MBLEDHJA